



**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. 901/4 Prot

Korçë më, 15.11.2024

Procesverbal Nr. 1

**i hartimit të kërkesave të veçanta teknike për kualifikim , kriterëve të vlerësimit,
specifikimeve teknike si dhe gjithë informacionit specifik**

Ky Procesverbal mbahet në bazë të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, te ndryshuar si dhe të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar nenit 78, si dhe në zbatim të Urdhrit Nr. 901/2 Prot., datë 15.11.2024 të Zyrtarit të Autorizuar të AK "Për caktimin e struktures pergjegjese që përgatit, kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit specifikimet teknike të DT , si dhe çdo informacioni tjetër specifik”, si dhe të Urdhrit për Prokurim Nr. 901/3 Prot., datë 15.11.2024 të nxjerrë nga Zyrtari i Autorizuar i AK , për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar ”, me objekt Mbikqyrja e puneve të objektit “Investime në ujesjellsa në fshatrat Sheqeras, Plase, Libonik, Drithas, Symiz, Pìrg dhe Kolanec në Njesinë Maliq të Ujesjelles Kanalizime Korçë Sh.a”, me fond limit prej 1.368.934,53 (Një milion e treqind e gjashtedhjetë e tete mijë e nenteqind e tridhjetë e kater presje pesedhjetë e tre) Leke pa TVSH.

Në nenin 78, pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

”Në çdo rast, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, nga specialisti/ët e fushës, duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit përgjegjës për prokurimin, i cili e bën pjesë të dosjes së tenderit.”

Hartimi i specifikimeve teknike, i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, i kriterëve të vlerësimit dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm është bërë në bazë të nevojës të UKRK për shërbimin e Mbikqyrja e puneve të objektit “Investime në ujesjellsa në fshatrat Sheqeras, Plase, Libonik, Drithas, Symiz, Pìrg dhe Kolanec në Njesinë Maliq të Ujesjelles Kanalizime Korçë Sh.a”.

Informacioni specifik lidhur me specifikimeve teknike është përgatitur me Procesverbalin për përllogaritjen e fondit limit Nr. 696/27 Prot., datë 09.10.2024 dhe ky informacion është pasqyruar në hartimin e Shtojcave 5, 6, 7 të DT.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike janë në përputhje me procedurën e punës të publikuar me të dhënat si me poshtë: Numri i referencës së procedurës: REF-23936-10-10-2024 "Investime në ujësjellës në fshatrat Sheqeras, Plase, Libonik, Drithas, Symiz, Pirg dhe Kolanec në Njesinë Maliq të Ujësjeselles Kanalizime Korçë Sh.a", ”.

Sipas dokumentave bashkangjitur.

Për zbatimin e punimeve të këtij projekti, UKRK Sh.A ka të domosdoshme prokurimin e shërbimeve të mbikqyrjes së punimeve në bazë të VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, e ndryshuar ku përcaktimi i fondit limit llogaritet sipas , **Seksionit II, grupit tarifor II.a, Seksionit III , grupit tarifor III.c , si dhe, të ndarë përkatësisht sipas preventivit të punimeve në shpenzime 97.31% dhe pajisje 2.69%, e veprës me vlerë totale 64.452.338,69 (Gjashtedhjetë e kater milion e katerqind e pesedhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tete presje gjashtedhjetë e nenete) pa TVSH .**

Afatet e ekzekutimit të shërbimeve:

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Informacioni i veçantë për kontratën përmban:

- Specifikimet teknike;
- Shërbimet dhe afatet e ekzekutimit
- Termat e referencës;
- kërkesat e teknike dhe profesionale për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit

dhe ky informacion është pasqyruar në hartimin e Shtojcave 5, 6, 7, 8 , si dhe tek Njoftimi i kontratës, të DT.

Informacione të veçanta për kontratën

Kriteret e veçanta teknike të kualifikimit/pjesëmarrjes

Natyra e shërbimeve shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP. **Kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.**

Më poshtë paraqiten arsyet konkrete që argumentojnë kriteret e vlerësimit për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti.

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në njëvlerë jo më të vogël se **20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ose 273.786,91 (Dyqind e shtatedhjetë e tre mijë e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë presje nentedhjetë e nje) Leke pa TVSH**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Baza ligjore e detajuar (VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 40, pika 4 “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Neni 55/4/b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që

prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria në objektin e prokurimit, çka rrit besueshmërinë e OE për realizimin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera 20% e fondit limit është përcaktuar bazuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr.285, dt. 19.05.2021, ndryshuar dhe është përcaktuar duke u lene mundesi bizneseve të nivelit të mesëm ose të vogël të konkurrojnë në këte procedure. Kjo kerkese pervecse provon faktin qe OE kane kryer furnizime te ngjashme te mallrave objekt prokurimi eshte vendosur ne raport me natyren e kontrates dhe vleren e perlllogaritur te saj.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale “Për Mbikqyrje e Kolaudim Punimesh Zbatimi”, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1. NP – 1 (Punime gërmimi në tokë).
2. NP – 2 (Ndërtime civile dhe industriale)
3. NP– 4 (Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhe me kavo, pista aeroportuale)
4. NP –7 a (Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
5. N.S.–4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.)
6. N.S. – 18 (Punime topogjeodezike)

(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të ndryshuar dhe të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.” i ndryshuar.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Kriteri dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përputhje me shërbimet e kërkuara të kontratës .

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

NP – 1 (Punime gjërmimi në tokë).

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

NP – 2 (Ndërtime civile dhe industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

NP – 4 (Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhe me kavo, pista aeroportuale)

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P – 7 a (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

N.S. – 4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S. – 18 (Punime topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

N.S.-20 (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.)

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve që do të mbikëqyren, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të mbikëqyren , që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1	Punime gërmimi në tokë	Mbikqyrje e: Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Gërmim me krahe ne seksion te detyruar me gjerësi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak. Gërmim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5 m
NP – 2	Ndërtime civile dhe industriale	Mbikqyrje e: Ndërtim godine per pusin Ndërtim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize

NP – 4	Rrugë,autostrada, mbikalime,hekurudha, linja tramvai ,metro, hekurudhë me	Mbikqyrje e: Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri
--------	---	---

	kavo dhe pista aeroportuale	Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
NP – 7 a	Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa,vepra kullimi e vaditje	Mbikqyrje e: FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm Ndertimi i rrjetit te brendshem Ndertim kaptazhesh Ndertimi i linjes se jashtme nga kaptazhi ne depo Ndertimi i pusit dhe godines se tij F.V. saracineska çeliku
N.S.– 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	Mbikqyrje e: Shtrese lluster cemento 1:2 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama F.V dritare druri kase binar teke xham F.V dyer druri
N.S.–18	Punime topogjeodezike	Mbikqyrje e: Ndertimi i AS_BUILD sipas kerkesave te specifikimeve teknike FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm Ndertimi i linjes se jashtme nga kaptazhi ne depo

3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të kenë të punësuar staf teknik për mbikëqyrjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose Inxhinier Ndertimi
- b. 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder
- c. 1 (një) Inxhinier Mekanik

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 10.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

Për inxhinieret duhet të paraqesë:

Kontratë pune të vlefshme, si dhe diplomë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve që duhen mbikëqyrur.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqese certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 39001 (Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vëndndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të

kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Kriteret për vlerësimin e ofertës

Për shërbimin e mbikeqyrjes të kërkuar, kriter vlerësimi do të jetë oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim sepse shërbimet kanë specifikime të thjeshta e standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg dhe çmimi është i vetmi element i mundshëm i ndryshueshëm ndërmjet ofertave, bazuar në nenin 45 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit përgjegjës për prokurimin znj. Ada Lumani që e bën pjesë të dosjes së tenderit.

Hartoi:

Ilia Papa (Inxhinier Gjeodet)